VENDIM
Nr. 93/2017

PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS ORGANIZATIVE, ORGANIKËS DHE KLASIFIKIMIT TË PAGAVE TË PERSONELIT TË KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT

(ndryshuar me vendimin nr. 100/2017, datë 4.10.2018 dhe nr. 83/2020, datë 23.12.2020; nr. 36/2022, datë 12.5.2022)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 78 dhe nenit C të Kushtetutës, si dhe të neneve 18, pika 1, dhe 29 të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

II. Organika dhe klasifikimi i pagave të personelit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit është sipas lidhjes nr. 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

III. Struktura organizative e personelit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit është sipas lidhjes nr. 2 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Miratuar në datën 29.9.2017

Lidhja nr. 1

ORGANIKA DHE KLASIFIKIMI I PAGAVE TË KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT

(ndryshuar me vendimin nr. 100/2017, datë 4.10.2018 dhe nr. 83/2020, datë 23.12.2020; nr. 36/2022, datë 12.5.2022)

FUNKSIONI ORGANIK	**Klasifikimi i pagës**	**Numri (2)**
I. KRYETAR	**G3***	**1**
Sekretar	Sekretar në kabinetin e kryetarit të Kuvendit**	1
II. KOMISIONERËT	**G3***	**(11)**

III. NJËSIA E SHËRBIMIT LIGJOR		**(36)**
Këshilltarë jurist	80% e pagës G3*	24
Këshilltarë ekonomistë	80% e pagës G3*	12
IV. SEKRETAR I PËRGJITHSHËM	**I-a**	**1**
V. DREJTORIA E MENAXHIMIT TË ÇËSHTJEVE DHE MARRËDHËNIEVE ME MEDIEN DHE PUBLIKUN		**(15)**
Drejtor	II-b	1
Specialist sekretarie gjyqësore	III-b	6
Specialist jurist	III-b	2
Specialist për zbardhjen dhe redaktimin e vendimeve	III-b	2
Përkthyes	II-b	2
Koordinator për medien dhe marrëdhëniet me jashtë	III-a	1
Specialist pritjeje me popullin	III-b	1
VI. DREJTORIA EKONOMIKE DHE E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE		**(11)**
Drejtor	II-b	1
Specialist financë/buxhet	III-b	1
Specialist i burimeve njerëzore	III-b	1
Specialist financë/prokurime	III-b	1
Specialist IT ***	III-b	1
Specialist protokolli/arkivi ****	III-b	2
Magazinier	VI	1
Punonjës pastrimi	II	2
Shofer/korrier	V	1
TOTAL		**76**

Shënim:

** Sipas ligjit "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".*

*** Kategoria e pagës për sekretarin e kryetarit është sipas vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e nëpunësve civilë në administratën shtetërore dhe institucione të tjera të pavarura.*

**** Punonjësit në pozicionin e specialistëve të teknologjisë së informacionit përfitojnë shtesën për natyrë të veçantë pune në masën dhe sipas kushteve të përcaktuara në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e nëpunësve civilë në administratën shtetërore dhe institucione të tjera të pavarura.*

***** Punonjësit në pozicionet specialist arkivi, përfitojnë shtesë për kushte të vështira e të dëmshme për shëndetin sipas kushteve dhe masës së përcaktuar në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e nëpunësve civilë në administratën shtetërore dhe institucione të tjera të pavarura.*

****** Përfitimet për kushtet e vështira e të dëmshme të shëndetit për punonjësit mbështetës janë sipas përcaktimeve në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore.*

Lidhja nr. 2

STRUKTURA ORGANIZATIVE E KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT
(ndryshuar me vendimin nr. 100/2017, datë 4.10.2018 dhe nr. 83/2020, datë 23.12.2020; nr. 36/2022, datë 12.5.2022)